



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe nenin 25, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 77/16 Gusht 2010), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2023 miratoi:

RREGULLORE PËR RAPORTIMIN E STATISTIKAVE TË INSTRUMENTEVE TË PAGESAVE

Neni 1

Qëllimi

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për arritjen e objektivave të saj, përpilon dhe publikon Statistikat e Instrumenteve të Pagesave. Rregullorja për Raportimin e Statistikave të Instrumenteve të Pagesave (në tekstin e mëtejme - Rregullorja) definon statistikave që duhet të raportohen, raportuesit dhe obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit, format e raportimit, konfidencialitetin, udhëzimet për hartimin e raporteve, si dhe standardet minimale të aplikuara për raportim.

Neni 2

Raportuesit

1. Bankat komerciale në mënyrë periodike raportojnë në BQK raportet e caktuara statistikore. Në pajtim me nenin 25, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2. të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, raportues janë të gjitha bankat komerciale në Kosovë.
2. BQK në raste të caktuara, mund të kërkojë nga bankat komerciale raporte statistikore shtesë bazuar në mostrën dhe format e përcaktuara paraprakisht. BQK i informon me shkrim dhe nëse është e nevojshme i kontakton subjektet që janë të përfshira në mostër për mënyrën në të cilën duhet të bëhet raportimi.

Neni 3

Obligimet statistikore të raportuesve

1. Raportuesit janë të obliguar që t'i ofrojnë informatat që i kërkon BQK me qëllim të përpilimit të Statistikave të Instrumenteve të Pagesave në nivel të Kosovës. Informatat e kërkuara statistikore duhet

të jenë të gatshme për BQK-në në formatet e caktuara nga BQK. BQK në parim përcakton subjektet individuale si njësi raportuese.

2. Për të gjithë raportuesit që nuk i përmbushin kërkesat statistikore të parapara me këtë rregullore, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Periudha e raportimit

1. Raportet statistikore duhet të dërgohen në BQK në periudha të rregullta, sipas afateve të paraqitura më poshtë:

<u>Raportet</u>	<u>Afati i raportimit</u>
• Raportet ditore	t+1 (1 ditë pas periudhës referuese)
• Raportet mujore për rezervën e obliguar	t+5 (5 ditë pas periudhës referuese)
• Raportet mujore për instrumentet e pagesave	t+15 (15 ditë pas periudhës referuese)

2. Nëse statistikat përfundimtare nuk janë në dispozicion brenda këtyre afateve, të dhënat e përkohshme duhet të dorëzohen në BQK brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore. Çdo revidim i statistikave nga ana e raportuesve duhet të raportohet përsëri në BQK, në momentin kur identifikohet ai.

Neni 5

Raportet

1. Bankat komerciale raportojnë në BQK në baza të rregullta periodike dhe në përputhje me afatet siç është specifikuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje. BQK-ja përmes Shtojcave të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje definon në mënyrë të detajuar raportet që dorëzohen në BQK. Udhëzimet për raportim përmbajnë format e detajuara për raportim dhe instruksionet mbi plotësimin e këtyre formave.
2. Raportet që dorëzohen në BQK janë:
 - 2.1. Raport ditor mbi paranë e gatshme në arkë të bankave komerciale (50%), për monitorim të rezervës së obliguar, e cila raportohet nga bankat komerciale drejtpërdrejtë në sistemin SPN (Sistemi i Pagesave Ndërbankare);
 - 2.2. Raporti mujor i depozitave të bankave për monitorim të rezervës së obliguar, që raportohet nga bankat komerciale drejtpërdrejtë në sistemin SPN (Sistemi i Pagesave Ndërbankare);
 - 2.3. Raportet mujore për statistikat e instrumenteve të pagesave përmes tabelave në vijim:
 - 2.3.1. Tabela 1. Statistika mbi numrin e llogarive të klientëve;
 - 2.3.2. Tabela 2. Kartelat bankare;
 - 2.3.3. Tabela 3. Terminalet për pagesat me kartela;

- 2.3.4. Tabela 4. Pagesat sipas instrumenteve;
- 2.3.5. Tabela 5. Transaksionet sipas tipit të terminaleve;
- 2.3.6. Tabela 6. Terminalet sipas komunave;
- 2.3.7. Tabela 7. Vlera aktive e parasë elektronike;
- 2.3.8. Tabela 8. Raporti për tentimet/keqpërdorimet përmes kartelave dhe transfereve.

Neni 6

Konfidencialiteti

Në pajtim me legjislacionin në fuqi, BQK respekton konfidencialitetin në lidhje me të dhënat individuale që dërgohen nga raportuesit, si dhe i përdorë ato të dhëna vetëm për qëllime statistikore, siç është përcaktuar në këtë rregullore.

Neni 7

Verifikimi dhe mbledhja e detyruar e informatave

BQK do të ushtrojë të drejtën për të verifikuar apo mbledhur në mënyrë të detyrueshme informacionin të cilin bankat janë të obliguara ta sigurojnë sipas kësaj rregulloreje. Në veçanti, BQK do të ushtrojë këtë të drejtë kur një bankë raportuese nuk i plotëson standardet minimale të raportimit (dërgimi, saktësia dhe pajtueshmëria me konceptet të specifikuara në Shtojcën 3).

Neni 8

Kualiteti i informatave të raportuara

Me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kualitetit të statistikave të raportuara, BQK bën monitorimin dhe vlerësimin e kualitetit të të dhënave të dërguara në BQK dhe ndërmerr të gjitha masat që i konsideron të arsyeshme dhe të nevojshme për t'u siguruar që cilësia e të dhënave të jetë në bazë të standardeve statistikore të përcaktuara.

Neni 9

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave, e miratuar nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, më datë 31 gusht 2017.

Neni 10

Shtojca

1. Pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje janë shtojcat në vijim:

- 1.1. Shtojca 1 – Përshkrimi i tabelave dhe udhëzime për plotësimin e tyre (format e tabelave të përgatitura nga BQK publikohen në faqen zyrtare të internetit të BQK-së);
- 1.2. Shtojca 2 – Përkufizimet e zërave të tabelave;
- 1.3. Shtojca 3 – Standardet minimale të aplikuara për raportim.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja
Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

SHTOJCA 1 – FORMAT E TABELAVE, PËRSHKRIMI I TYRE DHE UDHËZIMET PËR PLOTËSIM

Format e tabelave do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të BQK-së. Raportimi përmban gjithsej tetë (8) format e tabelave si vijon:

Tabela 1. Statistika mbi numrin e llogarive të klientëve

Kjo tabelë paraqet numrin e përgjithshëm të llogarive të klientëve të cilat mund të përdoren për qëllime pagesash, numri e klientëve të bankës raportuese, numrin e depozitave, numrin e përdorueseve aktiv përmes internetit (e-banking), si dhe numrin e llogarive të parasë elektronike.

Tabela 2. Kartelat bankare

Në këtë tabelë paraqitet numri i përgjithshëm i kartelave të lëshuara nga banka raportuese dhe të vlefshme në periudhën e raportimit.

Tabela 3. Terminalet për pagesa me kartela

Në këtë tabelë paraqitet numri total i terminaleve që janë në pronësi dhe/ose të instaluar nga banka raportuese deri në fund të periudhës për të cilën raportohet. Këtu përfshihen: Bankomatet (ATM), terminale në pikë të shitjes (POS) dhe terminalet për përdorimin e parasë elektronike. Gjithashtu, në këtë tabelë, paraqitet numri i përgjithshëm i tregtarëve në vend që janë të pajisur nga bankat me terminalet në pikë të shitjes.

Tabela 4. Pagesat sipas instrumenteve

Kjo tabelë përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) kategori, ku paraqiten numri dhe vlera e pagesave sipas instrumentit të përdorur për të kryer pagesën, brenda ose jashtë vendit. Raportimi bëhet i ndarë sipas valutave: në EUR, USD, CHF dhe valuta të tjera. Gjithashtu, kjo tabelë përfshin dhe ndarjen në llogaritë për individë dhe llogaritë afariste (aty ku është e nevojshme).

Tabela 5. Transaksionet sipas tipit të terminaleve

Kjo tabelë përfshin raportimin në numër dhe vlerë të transaksioneve me kartela në terminale.

Tabela 6. Terminalet sipas komunave

Kjo tabelë paraqet të gjitha terminalet si bankomatet/ATM dhe në pikat e shitjes/POS të shpërndara nëpër tërë komunat e Kosovës.

Tabela 7. Vlera aktive e parasë elektronike

Kjo tabelë paraqet vlerën e aktive të parasë elektronike e lëshuar nga bankat dhe e ruajtur në kartela, kompjuter personal, servera ose telefon mobil.

Tabela 8. Raporti për keqpërdorimet

Kjo tabelë përfshin raportimin në numër dhe vlerë të rasteve të keqpërdorimeve të transaksioneve përmes kartelave dhe transfereve.

Udhëzime për plotësimin e tabelave të raportimit

Tabela 1. Statistika mbi numrin e llogarive të klientëve

Llogaritë e klientëve raportohen të ndara në varësi të vendqëndrimit të klientit (rezident dhe jo-rezident), si dhe në varësi të llojit të llogarisë (individuale apo afariste). Po ashtu, duhet të raportohen edhe llogaritë në të cilat klientët kanë qasje përmes internetit (e-banking), llogaritë e lidhura me autorizime të debitimit direkt, si dhe llogaritë e lidhura me urdhëresa periodike.

Në këtë tabelë raportohen gjithashtu edhe llogaritë e klientëve në funksion të përdorimit të parasë elektronike.

Të gjitha llogaritë (llogaritë rrjedhëse, llogaritë e kursimeve, depozitat e klientëve / llogaritë e afatizuara, si dhe llogaritë në funksion të parasë elektronike) raportohen të ndara sipas valutës së llogarisë në EUR, USD, CHF apo valuta të tjera.

Gjithashtu, në këtë tabelë raportohen edhe numri i përdoruesve aktiv të shërbimit përmes internetit (e-banking) të cilët gjatë muajit raportues kanë pasur së paku një qasje në shërbimin qasje përmes internetit (e-banking) përmes kompjuterit apo përmes aplikacionit në telefon mobil. Raportimi bëhet për gjendjen e kategorive në ditën e fundit të periudhës referuese.

Tabela 2. Kartelat bankare

Të gjitha kartelat në qarkullim raportohen, pavarësisht se kur janë lëshuar apo nëse janë përdorur ato. Kartelat e skaduara, të mbyllura dhe ato që nuk janë dorëzuar te klientët nuk raportohen.

Kartelat e lëshuara nga vet tregtarët nuk raportohen, vetëm nëse janë lëshuar në bashkëpunim me ndonjë bankë.

Kartela me funksion paranë e gatshme (cash) përfshin kartelat që i mundësojnë mbajtësit të tërheq para të gatshme nga një bankomat (ATM) dhe/apo të deponojë para në bankomat (ATM).

Kartela me funksion pagese përfshin kartelën e cila ka së paku njërin nga funksionet në vijim: (a) funksion debiti, (b) funksion debiti të vonuar, (c) funksion krediti, (d) funksion debiti dhe/apo debiti të vonuar, si dhe (e) kartela me funksion krediti dhe/apo debiti të vonuar. Kartela po ashtu mund të ketë edhe funksione tjera, të tilla si funksionin e parasë elektronike, por kartelat me vetëm funksionin e parasë elektronike nuk raportohen në këtë kategori, por raportohen në kategorinë e kartelave me funksion paranë elektronike.

Nëse një “kartelë me funksion pagese” ofron disa funksione, ajo llogaritet në secilën nën-kategori të aplikueshme. Për këtë arsye numri i përgjithshëm i kartelave me funksion pagese, mund të jetë më i vogël se shuma e nën-kategorive. Për të shmangur llogaritjen e dyfishtë, nën-kategoritë nuk duhet të mbliidhen.

Një “kartelë me funksion paranë elektronike” mund të jetë një “kartelë në të cilën paraja elektronike mund të ruhet drejtpërdrejt” ose “një kartelë e cila jep qasje në paranë elektronike të ruajtur në një llogari të parasë elektronike”. Prandaj, numri i përgjithshëm i kartelave me funksion paranë elektronike është shuma e dy nën-kategorive.

Numri i përgjithshëm i kartelave paraqitet në “total numri i kartelave (pavarësisht prej numrit të funksioneve të kartelës)”. Ky tregues jo domosdoshmërisht duhet të jetë numri i përgjithshëm i “kartelave me funksion paranë e gatshme”, “kartelave me funksion pagese” dhe “kartelave me funksion paranë elektronike”, pasi që këto kategori mund të mos jenë reciprokisht përjashtuese.

Rubrika “kartelat me funksion të kombinuar debiti, paranë e gatshme dhe para elektronike” ju referohen kartelave të lëshuara nga një bankë, e cila ka funksion të kombinuar debiti, paranë e gatshme dhe para elektronike. Përveç kësaj, ato raportohen në secilën nën-kategori:

- a) “kartela me funksion paranë e gatshme”
- b) “kartela me funksion debiti”
- c) “kartela me funksion paranë elektronike”

Të dhënat për kartela po ashtu duhet të ndahen sipas operatorëve të kartelave të lëshuara nga banka raportuese, sipas këtyre kategorive: kartela lokale (të lëshuara nga vetë banka pa ndërmjetësimin e një operatori ndërkombëtar kartelash), Visa, MasterCard, apo të tjerë (operatorët e tjerë specifikohen nga vetë banka raportuese).

Në tabelën 2, po ashtu raportohet numri i mbajtësve të kartelave sipas grup-moshave të përcaktuara në tabelë dhe sipas gjinisë.

Tabela 3. Terminalet për pagesa me kartela

(I) Bankomate (ATM-të) - nëse një bankomat ofron funksione të ndryshme, ai raportohet në secilën prej nën-kategorive sipas funksioneve që ofron. Ndërsa në numrin total të bankomatëve çdo bankomat raportohet vetëm një herë, pavarësisht funksioneve që kryen.

(II) Terminalet në pikën e shitjes (POS) – këtu raportohet numri total i terminaleve në pikën e shitjes (POS-ve)/ terminali për transferimi elektronik të fondeve në pikën e shitjes (EFTPOS) në pronësi dhe/ose të instaluar nga banka raportuese, të cilat mundësojnë përdorimin e kartelave me funksion pagese pranë një pike shitjeje, me qëllim kryerjen e pagesave elektronike. Nga totali i terminaleve në pikën e shitjes (POS-ve), raportohen të ndara terminalet e mëposhtme:

1. Terminalet me funksion tërheqje të parasë së gatshme;
2. Terminalet për transferimin elektronik të fondeve në pikën e shitjes (EFTPOS);
3. Terminalet virtuale; dhe
4. Terminalet për përdorimin e parasë elektronike.

(III) Terminalet virtuale - këtu raportohet numri total i pikave të shitjes virtuale (virtual POS) - që mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit, me anë të kartelave për pagesa që punojnë në kohë reale;

(IV) Terminalet për përdorimin e parasë elektronike – raportohet numri total i terminaleve që lejojnë përdorimin e parasë elektronike. Këto terminale ndahen në:

1. Terminale për rimbushjen apo shkarkimin e tyre.

2. Terminale për kryerjen e pagesave me para elektronike.

Tabela 4. Pagesat sipas instrumenteve

(I) Në kategorinë e parë raportohen transferet e kreditit të iniciuara nga klienti pranë bankës raportuese të ndara sipas mënyrës në të cilën klienti dërgon instruksionet, në formë letër apo në formë elektronike. Pasi që kategoritë janë reciprokisht përjashtuese, numri i përgjithshëm i transferit të kreditit është shuma e nën-kategorive. I njëjti parim aplikohet edhe tek vlera e përgjithshme e transfereve të kreditit.

(II) Në këtë kategori raportohen pagesat të cilat kryhen nga klienti me anë të një kartele të lëshuar nga banka raportuese. Pagesat me këto kartela kryhen në të gjitha терминаlet (pikat e shitjeve/ POS) ose nëpërmjet kanaleve të tjera të ofruara nga banka (brenda ose jashtë vendit), si për shembull pagesat me kartela nëpërmjet internetit.

Tërheqjet dhe depozitimet në bankomatë/ATM, transferet nëpërmjet bankomatëve (ATM-ve), si dhe tërheqjet në para të gatshme nga pikat e shitjeve (POS) nuk përfshihen në këtë kategori.

Ndarjet e transaksioneve duhet të raportohen si në vijim:

- a) Pagesat me kartela me funksion debiti;
- b) Pagesat me kartela me funksion debiti të vonuar;
- c) Pagesat me kartela me funksion krediti;
- d) Pagesat me kartela me funksion debiti apo debiti të vonuar; dhe
- e) Pagesat me kartela me funksion krediti apo debiti të vonuar.

Nën-kategoritë “pagesat me kartela me funksion debiti apo debiti të vonuar” dhe “pagesat me kartela me funksion krediti apo debiti të vonuar” raportohen vetëm nëse funksioni specifik i kartelës nuk mund të identifikohet.

Çdo transaksion vendoset vetëm në një nën-kategori. Pasi që nën-kategoritë janë reciprokisht përjashtuese, numri i përgjithshëm i transaksioneve me kartela është shuma e nën-kategorive. Parimi i njëjtë aplikohet për vlerën e përgjithshme të transaksioneve me kartela.

Transaksionet e pagesave me kartela po ashtu janë të ndara në “të iniciuara në një terminal fizik për transferimin elektronik të fondeve në pikën e shitjes (EFTPOS)” dhe “të iniciuara nga distanca”.

Pagesat me kartela të lëshuara nga banka raportuese të cilat e kanë vetëm funksionin e parasë elektronike nuk duhet të përfshihen në këtë kategori.

(III) Në këtë kategori raportohen debitimet direkte të njëhershme ashtu edhe ato periodike. Në rastet e debitimeve direkte periodike, secila pagesë individuale llogaritet si një transaksion. Debitimi direkt raportohet nga banka e përfituesit.

(IV) Në këtë kategori raportohen pagesat me para elektronike, të iniciuara nga mbajtësi i parasë elektronike (urdhëruesi) për përfituesin. Këto pagesa raportohen të ndara në dy nën-kategori: (1) pagesa me para elektronike me kartela në të cilat paraja elektronike mund të ruhet drejtpërdrejt dhe (2) pagesa përmes llogarive të parasë elektronike.

(V) Çeqet - Pagesat me çeqe raportohen nga banka, ku përfituesi ka paraqitur çekun për rimbursim të parave nga ky çek. Në këtë kategori raportohen të gjitha llojet e çeqeve.

(VI) Pagesa me instrumente të tjera - Në këtë kategori raportohen pagesat e klientëve me instrumente të tjera, të cilat nuk përfshihen në asnjë nga pikat më lart.

(VII) Në këtë kategori raportohen transferet ndërkombëtare hyrëse, që banka raportuese proceson për klientët e saj.

(VIII) Në këtë kategori raportohen transferet ndërkombëtare dalëse, që banka raportuese proceson për klientët e saj.

(IX) Transaksionet përmes internetit (E-banking) - Në këtë kategori raportohen numri dhe vlera e transaksioneve përmes shërbimit të internetit të iniciuara përmes kompjuterit apo përmes aplikacionit në telefon mobil. Duhet të përfshihen transferet brenda vendit dhe ato ndërkombëtare të ndara në nënkategoritë individë dhe afaristë.

(X) Transaksionet përmes pikave të shitjes virtuale (E-commerce) në Kosovë - Në këtë kategori raportohen numri dhe vlera e transaksioneve të realizuara me kartela të klientëve të bankës raportuese në faqet e internetit të kompanive me bazë në Kosovë përmes pikave të shitjes virtuale (E-commerce) të cilin e ofron banka raportuese.

(XI) Transaksionet e Portofolit digjital (Digital wallet) - Këtu raportohen numri dhe vlera e transaksioneve të realizuara me kartela nga klientët e bankës raportuese përmes shërbimit që ofron banka me aplikacionin e telefonit të njohura si portofoli digjital në të cilin regjistrohen kartelat.

Tabela 5. Transaksionet sipas tipit të terminaleve

Llojet e transaksioneve të cilat raportohen në këtë tabelë, janë si më poshtë:

- a) Transaksione në терминаlet e instaluara nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka raportuese;
- b) Transaksione në терминаlet e instaluara nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga bankat jashtë vendit;
- c) Transaksione në терминаlet e instaluara nga bankat jashtë vendit, me kartela të lëshuara nga banka raportuese; dhe
- d) Transaksione në терминаlet e instaluara në vend nga bankat tjera, me kartela të lëshuara nga banka raportuese.

Në secilën kategori të mësipërme, transaksionet raportohen të ndara si në vijim:

1. Bankomat/ATM tërheqje e parasë së gatshme;
2. Bankomat/ATM depozitime;
3. Kredit transfere nëpërmjet bankomat-ve/ATM-ve;
4. Tërheqje e parasë së gatshme në terminale të pikave të shitjes/POS;
5. Pagesa me kartela në terminale të pikave të shitjes/POS;

6. Transaksione për mbushjen, rimbushjen ose tërheqje të vlerës së mbetur të parasë elektronike; dhe
7. Pagesa me kartela me funksion parandë elektronike.

Tabela 6. Terminalet sipas komunave

Në këtë tabelë raportohen terminalet bankomat/ATM dhe pika të shitjes/POS të shpërndara nëpër tërë komunat e Kosovës, sipas nën-kategorive të përcaktuara në formular.

Tabela 7. Vlera aktive e parasë elektronike

Vlera aktive e parasë elektronike ndahet në:

1. Vlera aktive të bazuara në kartelë (Card-based), ku raportohet vlera aktive e parasë elektronike e ruajtur në kartela.
2. Vlera aktive e parasë elektronike e bazuar në kompjuter (Computer – based), ku përfshihen:
 - a) Vlera e bazuar në formë Softuerike (Software based): raportohet vlera aktive e parasë elektronike e ruajtur në produkte të cilat bazohen në programe të instaluar në kompjuter personal dhe të cilat mundësojnë transferimin e vlerave elektronike nëpërmjet rrjeteve të telekomunikacionit si për shembull interneti.
 - b) Vlera e bazuar në rrjet (Network based): raportohet vlera aktive e parasë elektronike, me produkte të cilat ruajnë vlerën monetare në një server qendror. Kjo vlerë monetare përdoret për blerje në internet.
 - c) Vlera e bazuar në Telefonin Mobil (mobile based): raportohet vlera aktive e parasë elektronike ku vlera monetare e parasë ruhet në telefon mobil.

Tabela 8. Raporti për keqpërdorimet

Në këtë tabelë raportohen rastet e keqpërdorimeve përmes kartelave kur një transaksion është i suksesshëm.

Gjithashtu, në këtë tabelë raportohen edhe rastet e keqpërdorimeve përmes tranfereve, të ndara në transfere kombëtare dhe transfere ndërkombëtare.

SHTOJCA 2 – PËRSHKRIMI I PËRKUFIZIMEVE TË PËRDORURA NË TABELAT RAPORTUESE

Bankomati/ATM (automatic teller machine) – është pajisje elektromekanike që i lejon përdoruesit të autorizuar që duke përdorur kartela fizike të lexueshme nga pajisjet/makineritë, të tërheqin para nga llogaritë e tyre apo/dhe qasje në shërbime, duke ju mundësuar p.sh. kontrollimin e gjendjes së llogarisë, transferimin apo depozitimin e mjeteve. Një pajisje që lejon vetëm kontrollin e gjendjes së llogarisë, nuk llogaritet si bankomat/ATM.

Llogaria bankare – do të thotë çdo llogari e hapur në një bankë në bazë të një kontrate të lidhur ndërmjet një klienti dhe bankës dhe e cila përdoret për realizimin e transaksioneve të pagesave.

Vlera aktive e parasë elektronike – është vlera e parasë elektronike në fund të periudhës raportuese e mbajtur nga subjektet tjera me përjashtim të lëshuesit.

Depozitat në bankomat – nënkupton depozitimin e parave të gatshme në një bankomat duke përdorur një kartelë me funksion paranë e gatshme. Përfshinë të gjitha transaksionet në të cilat paraja e gatshme depozitohet në një terminal, pa ndonjë intervenim manual dhe paguesi identifikohet përmes kartelës për pagesë.

Tërheqjet e parave të gatshme në bankomat – do të thotë tërheqje e parasë së gatshme e realizuar në një bankomat duke përdorur një kartelë me funksion paranë e gatshme.

Bankomat me funksion tërheqjen e parave – nënkupton një bankomat që lejon përdoruesit e autorizuar të tërheqin para të gatshme nga llogaritë e tyre duke përdorur një kartelë me funksion paranë e gatshme.

Bankomat me funksion depozitimin e parave – nënkupton një bankomat që lejon përdoruesit e autorizuar të depozitojnë para të gatshme duke përdorur një kartelë me funksion paranë e gatshme.

Bankomat me funksion transferin e kreditit – nënkupton një bankomat që lejon përdoruesit e autorizuar të bëjnë transfere krediti duke përdorur një kartelë pagese.

Kartela – është instrument pagese që përdoret nga mbajtësi i saj për të kryer transaksione, si dhe për tërheqjen e parasë së gatshme.

Klient – nënkupton një person fizik ose juridik që shfrytëzon instrumentet e pagesës apo shërbimet e pagesave të ofruar nga institucioni i pagesave.

Pagesa me kartelë – është transaksion pagese i kryer me kartelë me funksion debiti, krediti apo debiti të vonuar, në një terminal apo përmes kanaleve tjera.

Pagesë me kartelë e iniciuar në një terminal fizik për transferimin elektronik të fondeve në pikën e shitjes (EFTPOS fizik) – nënkupton pagesat me kartela përmes një transferi elektronik të mjeteve në terminal të pikës së shitjes për transferimin elektronik të fondeve në lokacionin e shitësit. Këtu nuk raportohen transaksionet e pagesave me para elektronike.

Pagesa me kartela të lëshuara nga bankat në vend – janë transaksionet e pagesave të realizuara me kartela me funksion debiti, krediti apo debiti të vonuar, përmes një terminali apo përmes kanaleve tjera.

Të gjitha transaksionet e pagesave të iniciuara me kartelë duhet të përfshihen, d.m.th: a) të gjitha transaksionet në të cilat pranuesi dhe lëshuesi i kartelës janë subjekte të ndryshme; dhe b) të gjitha transaksionet në të cilat pranuesi dhe lëshuesi i kartelës janë subjekt i njëjtë.

Pagesa me kartela të lëshuara nga bankat e vendit, të iniciuara nga distanca – nënkupton transaksionet e pagesave me kartela të iniciuara në mënyrë elektronike, por që nuk janë iniciuar nga një terminal pikave të shitjes/POS fizik. Këtu raportohen pagesat me kartela për produkte dhe shërbime të blera përmes internetit.

Kartela me funksion paranë e gatshme – nënkupton kartelën që i mundëson mbajtësit të tërheq para të gatshme nga një bankomat dhe/apo të depozitoje para në bankomat.

Kartela me funksion të kombinuar të parasë së gatshme, debiti dhe parasë elektronike – nënkupton një kartelë të lëshuar nga një bankë, e cila ka funksione të kombinuara të parasë së gatshme, debilit dhe para elektronike.

Kartela me funksion krediti apo debiti të vonuar – kjo kategori raportohet vetëm nëse të dhënat nuk mund të ndahen në “kartela me funksion krediti” dhe “kartela me funksion debiti të vonuar”.

Kartela me funksion krediti – nënkupton një kartelë që i mundëson mbajtësit të kryej blerje dhe në disa raste gjithashtu të tërheqin para të gatshme deri në një limit të paracaktuar. Krediti i lejuar mund të shlyhet si i tërë në fund të periudhës së caktuar, apo mund të shlyhet në pjesë, me bilancin e marr si kredi shtesë në të cilin zakonisht paguhet interes. Tipari dallues i një karteje me funksion krediti në krahasim me kartelat me funksion debiti apo debiti të vonuar, është marrëveshja kontraktuale që i jep mbajtësit të kartelës një linjë krediti për kredinë e akorduar.

Kartela me funksion debiti apo debiti të vonuar – kjo kategori raportohet vetëm nëse të dhënat nuk mund të ndahen në “kartela me funksion debiti” dhe “kartela me funksion debiti të vonuar”.

Kartela me funksion debiti – nënkupton një kartelë që i mundëson mbajtësit që blerjet t’i realizojë direkt dhe menjëherë nga llogaria. Kartela me funksion debiti mund të jetë e lidhur me një llogari që ofron mundësi për mbiterheqje si karakteristikë shtesë. Numri i kartelave me funksion debiti i referohet totalit të numrit të kartelave në qarkullim dhe jo numrit të llogarive në të cilat kartelat janë të lidhura. Tipari dallues i një karteje me funksion debiti krahasuar me një kartelë me funksion krediti apo debiti të vonuar, është marrëveshja kontraktuale për t’i realizuar pagesat drejtpërdrejt në fondet në llogari rrjedhëse të mbajtësit të kartelës.

Kartela me funksion debiti të vonuar – nënkupton një kartelë që i mundëson mbajtësit që blerjet t’i ketë të ngarkuara në një llogari të lëshuesi i kartelës, deri në një limit të autorizuar. Bilanci në këtë llogari shlyhet si i tërë në fund të periudhës të paracaktuar. Tipari dallues i një karteje me funksion debiti të vonuar krahasuar me një kartelë me funksion krediti apo debiti, është marrëveshja kontraktuale që lejon një linjë krediti por me obligimin për shlyerje të borxhit të paraqitur në fund të një periudhe të paracaktuar. Këtij lloji të kartelave zakonisht ju referohemi si kartat për pagesë (charge cards).

Kartela me funksion pagese – nënkupton një kartelë e cila ka së paku njërin nga funksionet në vijim: funksion debiti, funksion debiti të vonuar apo funksion krediti. Kartela po ashtu mund të ketë edhe funksione tjera, të tilla si funksionin e parasë elektronike.

Kartela me funksion paranë elektronike – nënkupton një kartelë që mundëson transaksione me para elektronike. Janë të përfshira kartelat në të cilat paraja elektronike mund të ruhet drejtpërdrejt dhe kartelat të cilat japin qasje në paranë elektronike të ruajtur në një llogari të parasë elektronike.

Tërheqje e parave të gatshme në терминаlet e Pikave të shitjes/POS – nënkupton transaksionet në të cilat mbajtësi i kartelës pranon para të gatshme në një terminal të pikave të shitjes në kombinim me një transaksion pagese për mallra dhe shërbime. Nëse nuk është e mundur të ndahen të dhënat për paradhëniet në терминаlet e pikave të shitjes, këto të dhëna raportohen në “pagesa me kartela në pikat e shitjes”.

Çeku – është një urdhër i shkruar nga një palë, d.m.th. lëshuesi i çekut, për dikë tjetër, d.m.th. marrësi i çekut, që zakonisht është një bankë, duke i kërkuar marrësit të paguajë një shumë të caktuar sipas kërkesës së lëshuesit, ose tek një palë e tretë e përcaktuar nga lëshuesi.

Transfer krediti – është shërbim i pagesës i cili i lejon paguesit të udhëzojë institucionin në të cilin mban llogari të transferojë fondet për përfituesin. Është një urdhërpagesë e bërë me qëllim të vendosjes së mjeteve në dispozicion të përfituesit, ku përfshihen edhe transferet e kreditit në bankomat me funksion krediti.

Transfer i kreditit i iniciuar në formë letër – janë transferet e kreditit të cilat urdhëruesi i paraqet në formë letër.

Transferi i kreditit i iniciuar në mënyrë elektronike – është çdo transfer krediti të cilin paguesi e dërgon pa përdorimin e formave në letër, d.m.th. në mënyrë elektronike. Kjo kategori përfshin urdhëresat periodike të dorëzuara fillimisht në formë letër, por të ekzekutuara më pas në mënyrë elektronike dhe gjithashtu transferin e kreditit të iniciuar në një bankomat me funksion transferin e kreditit.

Shërbimet përmes internetit (E-banking) – është një shërbim, që lejon mbajtësin të realizojë transaksione të pagesave, përfshirë urdhërpagesat, nga distanca duke përdorur internetin.

Shërbimet përmes telefonit mobil (Mobile Banking) – është një shërbim që lejon mbajtësin të përdorë telefonin celular për të realizuar transaksione të pagesave, përfshirë mundësinë për të bërë urdhërpagesa nga një llogari e pagesave.

Pikat virtuale të shitjes/POS Virtual (E-commerce) – është një shërbim që lejon shitjen ose blerjen e mallrave ose shërbimeve nëpërmjet transaksioneve elektronike të kryera nëpërmjet faqeve të internetit ose rrjeteve të tjera të ndërmjetësuara nga kompjuteri.

Portofoli digjital (digital wallet) – është një shërbim përmes internetit që qaset përmes një pajisjeje që lejon përdoruesin përfundimtar të qaset dhe të menaxhojë në mënyrë të sigurt fondet.

Tregtar – është personi fizik ose juridik, i cili në bazë të kontratës së lidhur me pranuesin, pranon pagesat me instrument të pagesave elektronike (IPE) nëpërmjet përdorimit të një pajisje pikë e shitjes / terminal të pikës së shitjes për transferimin elektronik të fondeve / pikë e shitjes virtuale (POS/EFTPOS/virtual POS).

Pagesat ndërkombëtare – nënkupton një transaksion pagese të iniciuar nga një urdhërues apo përfitues, ku banka e urdhëruesit dhe përfituesit janë të vendosura në shtete të ndryshme.

Terminalet të pikës së shitjes për transferimin elektronik të fondeve (EFTPOS) – janë терминаlet të cilat e marrin informacionin e pagesës me mjete elektronike dhe janë të dizajnuara që të dërgojnë atë informacion qoftë online, me kërkesë në kohë reale për autorizim, apo offline.

Paraja elektronike – nënkupton një vlerë monetare të ruajtur në mënyrë elektronike apo magnetike e paraqitur si kërkesë ndaj lëshuesit e cila është lëshuar në pranim të fondeve me qëllim të kryerjes së transaksioneve të pagesave, dhe e cila pranohet nga një person fizik apo juridik, përveç lëshuesit të parasë elektronike.

Llogaritë e parasë elektronike – janë llogaritë në të cilat paraja elektronike ruhet. Bilanci në llogari mund të përdoret nga mbajtësi i llogarisë për të kryer pagesa dhe të transferojë mjete mes llogarive. Kartelat në të cilat paraja elektronike mund të vendoset drejtpërdrejt nuk raportohen.

Terminale për përdorimin e parasë elektronike – janë терминаlet që i lejojnë mbajtësit të parasë elektronike në kartelë me funksion paranë elektronike të transferojë vlera të parasë elektronike nga bilanci i tij në bilancin e përfituesve.

Terminale për rimbushjen apo shkarkimin e parasë elektronike – janë терминаlet që lejojnë transferin e vlerave elektronike nga një lëshues i parasë elektronike te mbajtësi i kartelës me funksion paranë elektronike dhe anasjelltas d.m.th. mbushjen dhe zbrazjen e kartelës.

Mbushja dhe zbrazja e kartelës me funksion paranë elektronike – nënkupton transaksionet që lejojnë transferin e vlerave të parasë elektronike nga një lëshues i parasë elektronike në një kartelë me funksion paranë elektronike dhe anasjelltas. Këtu përfshihen transaksionet mbushëse edhe ato zbrazëse.

Pagesë me para elektronike – nënkupton një transaksion përmes të cilit një mbajtës i parasë elektronike transferon vlerën e parasë elektronike nga bilanci i tij në bilancin e përfituesit, ose me një kartelë në të cilën paraja elektronike mund të ruhet drejtpërdrejt apo me llogari tjera të parasë elektronike.

Pagesë me paranë elektronike me kartela në të cilat paraja elektronike mund të vendoset drejtpërdrejt – nënkupton një transaksion ku mbajtësi i kartelës me funksion paranë elektronike transferon vlera të parasë elektronike nga bilanci i tij i mbajtur në kartelë në bilancin e përfituesit.

Pagesa me para elektronike përmes llogarive të parasë elektronike – nënkupton një transaksion ku fondet transferohen nga llogaria e parasë elektronike e urdhëruesit në llogarinë e përfituesit.

Pagesat me para elektronike përmes llogarive të parasë elektronike, nga të cilat: të qasura përmes një karte – nënkupton një transaksion ku një kartelë përdoret për tu qasur në një llogari të parasë elektronike dhe më pas fondet transferohen nga llogaria e parasë elektronike e urdhëruesit në llogarinë e përfituesit.

Rezident – nënkupton subjektet juridike që janë të regjistruara dhe që veprojnë në Kosovë, si dhe personat fizikë vendbanimi i të cilëve gjendet në Kosovë dhe të cilët nuk largohen nga Kosova për periudhë më të gjatë se një vit (përveç diplomatëve, studentëve dhe pacientëve mjekësor). Me fjalë të tjera, sipas definicioneve të Fondit Monetar Ndërkombëtar, rezident të një vendi të caktuar janë subjektet fizike dhe juridike qendra e interesit ekonomik e të cilëve qëndron në vendin në fjalë.

Jo-rezident – nënkupton çdo person fizik apo juridik që funksionon në bazë të veprimtarisë së tij në çdo shtet tjetër përveç Kosovës. Degët apo nëndegët e një kompanie jorezidente që veprojnë në Kosovë, janë rezident të Kosovës. Në përputhshmëri me këtë, çdo degë apo nëndegë e një kompanie kosovare që vepron jashtë Kosovës është jorezident i Kosovës.

Terminali për pikën e shitjes (POS) – është një pajisje që lejon përdorimin e kartelave për pagesa në një pikë shitëse fizike (jo virtuale). Informacioni i pagesës merret ose manualisht në kupona letre apo me mjete elektronike d.m.th. në terminalin e pikës së shitjes për transferimin elektronik të fondeve. Terminali për pikën e shitjes është i projektuar të mundësoj dërgimin e informatave online (me kërkesë në kohë reale për autorizim) ose offline.

Terminalet virtuale (virtual POS) – është pajisja apo aplikacioni i ngjashëm në shërbime me terminalin e pikave të shitjes, që mundëson kryerjen e transaksioneve nëpërmjet internetit ose telefonave, me anë të kartelave për pagesa që punojnë në kohë reale;

Debitimi Direkt – do të thotë transferi i debitit, ku iniciatori është klienti përfitues, bankë iniciuese është banka e klientit përfitues, bankë pranuese është banka e klientit urdhërues dhe pranues është klienti urdhërues.

Pagesat me kartela në terminale të pikave të shitjes – janë transaksionet e realizuara përmes një POS terminali duke përdorur një kartelë me funksion debiti, krediti apo debiti të vonuar. Këtu nuk përfshihen transaksionet me kartelë me funksion parandë elektronik.

Transaksione në терминаlet e instaluar nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga banka raportuese – janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha терминаlet e bankave raportuese ku transaksionet realizohen me kartela të lëshuara nga bankat raportuese.

Transaksione në терминаlet e instaluar nga banka raportuese, me kartela të lëshuara nga bankat jashtë vendit – janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha терминаlet e bankave raportuese ku transaksionet realizohen me kartela të lëshuara nga bankat jashtë vendit.

Transaksione në терминаlet e instaluar nga bankat jashtë vendit, me kartela të lëshuara nga banka raportuese – janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha терминаlet e bankave jashtë vendit, me kartela të lëshuara nga bankat raportuese.

Transaksione në терминаlet e instaluar në vend nga bankat tjera, me kartela të lëshuara nga banka raportuese – janë transaksionet e pagesave të realizuara në të gjitha терминаlet e bankave tjera në vend, me kartela të lëshuara nga bankat raportuese.

Vlera aktive e parasë elektronike – është vlera e parasë elektronike në fund të periudhës raportuese e mbajtur nga subjektet tjera me përjashtim të lëshuesit.

SHTOJCA 3 - STANDARDET MINIMALE TË APLIKUARA PËR RAPORTIM

Raportuesit duhet të përmbushin standardet e mëposhtme minimale për t'i plotësuar kërkesat e BQK-së për raportime statistikore.

1. Standardet minimale për dërgim të raporteve
 - a) Raportimet duhet të bëhen me kohë dhe brenda afateve të përcaktuara nga BQK-ja;
 - b) Raportet statistikore duhet të plotësohen sipas formularëve të përcaktuar nga BQK-ja;
 - c) Raportuesit duhet të ofrojnë në BQK të dhëna për një ose më shumë persona kontaktues;
2. Standardet minimale për saktësi
 - a) Informatat statistikore duhet të jenë të sakta: të gjitha fushat duhet të plotësohen (p.sh. nënkategoritë mblidhen për të dhënë totalin) dhe të dhënat duhet të jenë konsistente gjatë gjithë periudhave raportuese;
 - b) Raportuesit duhet të jenë në gjendje të sigurojnë informacione shtesë mbi zhvillimet e nënkuptuara nga të dhënat e dërguara;
 - c) Raportet statistikore duhet të jenë të kompletuara dhe të mos përmbajnë dallime të vazhdueshme dhe mospërputhje; mospërputhjet ekzistuese duhet të verifikohen dhe shpjegohen për BQK-në dhe më pas të përmirësohen sa më shpejt të jetë e mundur;
 - d) Raportuesit duhet t'i përmbahen politikave të përcaktuara nga BQK-ja në lidhje me kriteret teknike për dërgimin e të dhënave statistikore;
3. Standardet minimale për pajtueshmërinë me konceptet
 - a) Informatat statistikore duhet të përputhen me definicionet dhe klasifikimet të përcaktuara në këtë rregullore;
 - b) Në rast të devijimeve nga këto definicione dhe klasifikime, raportuesit duhet të monitorojnë dhe përcaktojnë dallimin në mes të masave të përdorura kundrejt masave të përcaktuara me këtë rregullore;
 - c) Raportuesit duhet të jenë në gjendje të shpjegojnë dallimet në të dhënat e dërguara krahasuar me ato të periudhave paraprake.